

VENDIM
Nr.7, datë 16.9.1992

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Thimjo Kondi	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Ylvi Myrtja	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese
Natasha Sheshi	Anëtare i	Gjykatës Kushtetuese
Franc Jakova	Anëtar i	Gjykatës Kushtetuese

Me sekretare Drita Filto, më datat 4 dhe 9 shtator 1992, shqyrtoi në seancë gjygjësore me dyer të hapura çështjen nr.9 që i përket:

KËRKUESE: Kryesia e Partisë Komuniste të Shqipërisë, e përfaqësuar nga zotërinjtë Hysni Milloshi, Selfo Kuka, Hekuran Osmani, Ndue Gjini, Preng Çuni, Sami Meta dhe Preng Lleshi, me autorizim.

OBJEKTI I KËRKESËS:

1. Deklarimi antikushtetues i ligjit nr.7591, datë 16.7.1992, për ndryshimin e përmbajtjes së gërmës "b" të nenit 6 të ligjit "Për Partitë Politike"
2. Anulimin e urdhërit nr.43/2, datë 17.7.1992, të Ministrit të Drejtësisë për nxjerrjen jashtë ligjit të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relacionin përkatës,

VËREN:

Me ligjin nr.7591, datë 16.7.1992, të shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr.251, datë 17.7.1992, gërma "b" e nenit 6 të ligjit nr.7502, datë 25.7.1991 "Për Partitë Politike", në të cilin përcaktohen rastet kur nuk lejohet krijimi ose ndalohet veprimtaria e partive politike, është ndryshuar si vijon: "Kur qëllimet e veprimtaria e saj kanë karakter antikombëtar, shovinist, racist, totalitarist, fashist, stalinist, enveristo-komunist dhe marksist-leninist".

Ministri i Drejtësisë me urdhërin nr.43/2, datë 17.7.1992, ka urdhëruar: "Nxjerrjen jashtë ligjit të Partisë Komuniste të Shqipërisë si dhe çregjistrimin e saj, ndalimin e veprimtarisë së organeve dhe organizatave komuniste".

Kryesia e Partisë Komuniste të Shqipërisë, ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese:

1. Të deklarohet antikushtetuese përmbajtja e gërmës "b" të nenit 6 sepse:

a) në Dispozitat Kryesore Kushtetuese lejohet pluralizmi partiak pa u vënë ndonjë kufizim për parti të veçanta, pra nuk mund të vihen kufizime me ligj;

b) ndryshimet që i janë bërë kësaj dispozite duke u shtuar fjalët : "stalinist, enveristo-komunist dhe marksist-leninist", janë bërë me qëllim për të nxjerrë jashtë ligjit Partinë Komuniste të Shqipërisë;

2. Anullimin e Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë për nxjerrjen jashtë ligjit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, meqenëse ajo është një parti e re me program demokratik dhe nuk i ka karakteristikat që përshkruhen në gërmën "b" të nenit 6.

Lidhur me kërkesën e parë, Gjykata çmon se në Dispozitat Kryesore Kushtetuese sanksionohet parimi i pluralizmit partiak. Në paragrafin e dytë të nenit 6 të këtyre Dispozitave thuhet se: "Partitë politike dhe organizatat e tjera, krijohen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin".

Moslejimi me ligj i krijimit dhe veprimtarisë së partive politike, kur qëllimet dhe veprimtaria e

tyre kanë karakter antikombëtar, enveristo-komunist, marksist-leninist etj, nuk vjen në kundërshtim me parimin e pluralizmit partiak. Sipas "Dispozitave kryesore kushtetuese", Republika e Shqipërisë është shtet juridik dhe demokratik. Nga kjo del që qëllimet dhe veprimtaria e partive politike duhet të zhvillohen vetëm mbi parime demokratike. Nuk mund të lejohet veprimtaria e partive politike që kanë në themel parime antidemokratike si rrëzimin me dhunë të rendit kushtetues, hapjen dhe kufizimin e lirive demokratike të shtetasve, diktaturën e proletariatit, luftën e klasave etj.

Ndërsa kërkesa për anulimin e Urdhërit të Ministrisë të Drejtësisë për nxjerrjen jashtë ligjit të Partisë Komuniste të Shqipërisë nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Sipas nenit 13 të ligjit nr.7502, datë 25.7.1991 "Për Partitë Politike", "kundër aktit të Ministrisë të Drejtësisë, që refuzon kërkesën për formimin e një partie, që ndalon vazhdimin e veprimtarisë së saj ose që nuk pranon kërkesën për ndryshime në program, statut dhe në emërtimin e partisë, mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit në Gjykatën e Lartë, e cila brenda 15 ditëve merr vendim të formës së prerë".

Me ndryshimet që janë bërë në sistemin e organeve gjyqësore, Gjykatës së Kasacionit i janë lënë të gjitha kompetencat që ka patur Gjykata e Lartë, me përjashtim të atyre që janë ndryshuar shprehimisht me ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës për deklarimin antikushtetues të ligjit nr.7591, datë 16.7.1992.

Të deklarojë jashtë kompetencave të saj shqyrtimin e kërkesës për anulimin e urdhërit të Ministrisë të Drejtësisë nr.43/2, datë 17.7.1992.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin e tij në "Fletoren Zyrtare".

Tiranë, më 16.9.1992